

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Janar, 2015*

SBASHK-u i vendosur në mbrojtje të Kontratës Kolektive
U fillua me veprimet e para sindikale



Në përpjekje të shumta për të gjetur mënyrën e implementimit të plotë të Kontratës Kolektive, SBASHK-u filloi edhe me veprime sindikale të përshkallëzuara. Në kuadër të këtyre përpjekjeve Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në takimin e datës 10 janar 2015

vendosi që me datën 13 janar të fillohet me veprimin e parë sindikal (grevë një-orëshe në të dy ndërrimet), me datën 22 janar veprimi i dytë sindikal (grevë dy-orëshe në të dy ndërrimet) dhe me datën 30 janar me veprimin e tretë sindikal (grevë një-ditëshe) ... [\(faqe 4\)](#)

Takim me Ministrin e MASHT-it, z.Arsim Bajrami
Udhëheqësit e SBASHK-ut u takuan me Ministrin Bajrami
Në përpjekje që të gjendet mënyra [\(faqe 7\)](#)

Marrëveshje të reja në shërbim të anëtarësisë
SBASHK-u vazhdon me angazhimet në shërbim të anëtarësisë
Ka arritur në 90 numri i marrëveshjeve... [\(faqe 8\)](#)

Intervistë me UD Kryetarit të Sindikatës Komunale të SAF dhe SAM – Mitrovicë
Shembulli i forcimit të rolit të femrës në SBASHK

Ajo përfaqëson 1100 mësimdhënës ... [\(faqe 3\)](#)

Në korrik mbahet Kongresi 7-të i EI-së

SBASHK-u përfaqëson Kosovën në Otavë (Kanada)



Në korrik të vitit 2015 në Otavë të Kanadasë do të mbahet Kongresi 7 i Edukimit Internacional (EI) . Në këtë Kongres do të marrin pjesë... [\(faqe 7\)](#)

SBASHK-u u takua me Kryeministrin Mustafa

As takimi me Kryeministrin nuk solli marrëveshje



Duke i dhënë rëndësi të vazhdueshme dialogut për të gjetur zgjidhje ndaj kërkesave legjitime të mësimdhënësve më 23 janar kryetari i SBASHK-ut, z.Rrahman Jasharaj ... [\(faqe 7\)](#)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Shkencës

KEC

Editorial

Në shërbim të realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë

Janari erdhi. Mësimdhënësit ishin në pritje. Qeveria e re nisi punën. Deklaratat e para ishin të ftohta. Mësimdhënësit reagues përmes sindikatës së tyre. SBASHK-u u ftua në takime të ministri Hoti, të kryeministri Mustafa. U zhvilluan shumë takime me ministrin Bajrami e me kabinetin e tij. SBASHK-u mbronte ligjshëm kërkesën për implementimin Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar. Qeveria nuk po tregohej e gatshme për të implementuar në tërësi Kontratën dhe prandaj SBASHK-u duke respektuar zërin e mijëra anëtarëve mbajti takimin e Këshillit Drejtues më 10 janar dhe u vendos të nisej me veprime të përshkallëzuara sindikale.

SBASHK-u duke qenë thellësisht i interesuar për t'i dhënë hapësirë zgjidhjes me dialog i la kohë Qeverisë të reflektonte. Veprimet filluan me 13 janar me grevën njëorëshe. Nuk pati reflektim. U vazhdua më 22 janar me grevën e fuqishme dyorëshe. Kishte angazhime e takime, por jo edhe përmbushje të kërkesave. U mbajt greva e përgjithshme njëditëshe e 30 janarit dhe ajo dëshmoi edhe një herë për unitetin e shkëlqyer të SBASHK-ut. Grevës iu përgjigjen 99 % të institucioneve arsimore të Kosovës. Në këtë grevë bashkë ishin institucionet e të tri niveleve arsimore. Institucionet lokale e qendrore të pushtetit në Kosovë duhet ta lexojnë qartë këtë paralajmërim dhe të ulen e të ofrojnë zgjidhje sepse kjo është e mundur vetëm se do pak më shumë vullnet. Do qasje korrekte e serioze të



Institucioneve. Të ofrosh zgjidhje për kërkesat legjitime të mësimdhënësve është largë e borxhit ndaj punës dhe misionit të tyre të shenjtë nëpër vite e dekada. SBASHK-u pret reflektimin e Institucioneve lokale e qendrore në shërbim të arsimit dhe në përmbushjen e kërkesave legjitime të këtij sektori me rëndësi të veçantë. SBASHK-u, edhe pse para kësaj sfide bukur të madhe, vazhdoi të kryente detyra nga misioni i saj për shërbime sa më të shumta e më cilësore për mësimdhënësit sindikalistë. Vazhduan të nënshkruhen marrëveshje e marrëveshje me bizneset private e me institucione shëndetësore për shërbime me zbritje çmimesh për anëtarët e SBASHK-ut. Punuam edhe në drejtime të tjera dhe përherë në shërbim të anëtarësisë. Kështu do të vazhdojmë edhe sot e gjithmonë.

Dhe për një gjë ju siguroj: zëri i juaj mësimdhënës do të dëgjohet e do të respektohet në secilin hap që SBASHK-u do të ndërmer në realizimin e kërkesave të përbashkëta që burojnë nga kontrata jonë kolektive me shtetin.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", SBASHK-u së shpejti do të ofroj shërbime juridike për anëtarët e vet.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Intervista

Intervistë me UD Kryetare e SAF dhe SAM – Mitrovicë

Shembulli i forcimit të rolit të femrës në SBASHK



UD-Kryetare e SAF dhe SAM-Mitrovicë, znj.Vjollca Shala

Arsimimi Sot :

1. Kush është Vjollca Shala?

Shala:

Jam e lindur në Mitrovicë shkollën fillore dhe të mesme e kam mbaruar në Mitrovicë. Fakultetin Elektroteknikë drejtimin "Kompjuterikë me telekomunikacion" e kam mbaruar në Universitetin e Prishtinës. Master i shkencave kompjuterike në Fakultetin Politeknik në Universitetin e Tiranës. Tani kam temën "Analiza e karakteristikave,avantazheve dhe dobësive të sistemeve të ndryshme operative mobile" për ta mbrojtur dhe të marrë titullin Magjistër (shkallës së dytë) i Informatikës pran Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Punoj në gjimnazin "Frang Bardhi"në Mitrovicë profesoreshë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit .Jam ushtrues detyre e kryetarit sindikal të AF dhe AM në Mitrovicë.

Arsimimi Sot:

2.Sa është e përfaqësuar femra në procesin edukativo-arsimor në komunën tuaj?

Shala:

Në komunën time femra është e përfshirë në procesin edukativo-arsimor, pasi mbi 56% të arsimit fillorë dhe arsimit të mesëm e mbulojnë femrat në Mitrovicë.

Arsimimi Sot:

3. Cili është roli i femrës në angazhimin sindikal në komunën tuaj?

Shala:

Në komunën time angazhimi sindikal i femrës nuk është i kënaqshëm .Nga 27 shoqata sa i kemi në Mitrovicë vetëm gjashtë femra janë kryetare të shoqatave. Unë shfrytëzoj rastin t'ju bëjë apel të gjitha femrave që mos të hezitojnë, deri sa ato janë të suksesshme në procesin edukativo-arsimor edhe në angazhimet sindikale do të jenë shume me të suksesshme.

Arsimimi Sot:

4.Jeni shumë aktive në sindikatë. Si e arrini këtë?

Shala:

Me vullnet dhe dëshirë çdo gjë arrihet. Puna në sindikatë është në baza vullnetare, por sindikata është e vetmja organizatë që punon për të drejtat e punonjësve të arsimit e kjo është arsyeja që unë jam në sindikatë.

Arsimimi Sot:

5. Çfarë I propozoni SBASHK-ut të bëjë më shumë në shërbim të anëtarësisë?

Shala:

Shërbime në përputhje me nevojat e anëtarësisë si zhvillim profesional,shkëmbim të përvojave brenda SBASHK-ut , nxitje dhe mbështetje të kryetarëve sindikal të komunave për organizim të trajnimeve me anëtarësinë komunale si dhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me sindikatat ndërkombëtare.

Arsimimi Sot:

6. Si I vlerësoni veprimet sindikale të SBASHK-ut për realizimin e Kontratës Kolektive?

Shala:

Pas shume përpjekjeve të Kryesisë së SBASHK-ut për zbatimin e Kontratës Kolektive nga ana e Qeverisë,SBASHK-u nuk pati rrugë dalje tjetër përveç veprimeve që i ka ndërmarrë. Në shtetet normale dhe të përgjegjshme është e pakuptueshme që shteti nuk implementon kontratat e nënshkruara .

Arsimimi Sot:

7. A keni ndonjë propozim konkret për hapa të mëtejme të veprimeve sindikale, nëse nuk realizohen kërkesat e anëtarësisë?

Shala:

Nëse edhe pas grevës një ditore me 30 janar 2015 dhe në afatin e mjaftueshëm që do ti lihet qeverisë për të gjetur zgjidhje për implementim të plotë të Kontratës Kolektive, nuk reflekton nuk na mbetet rrugë tjetër vetëm të hyjmë në grevë të përgjithshme.

Arsimimi Sot:

8.A keni diçka të veçantë për të shtuar?

Shala:

Ftoj të gjithë punonjësit e arsimit që nuk janë anëtarë të SBASHK-ut të anëtarësohen në SBASHK, pasi SBASHK-u është e vetmja organizatë legjitime që mbron interesat e tyre dhe njëherit i bëjmë apel qeverisë që të reflektoj në zbatimin e Kontratës Kolektive që mos të vie deri te e padëshirueshmja.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Gjatë muajit

SBASHK-u i vendosur në mbrojtje të Kontratës Kolektive

U fillua me veprimet e para sindikale

Në përpjekje të shumta për të gjetur mënyrën e implementimit të plotë të Kontratës Kolektive, SBASHK-u filloi edhe me veprime sindikale të përshkallëzuara.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në takimin e datës 10 janar 2015 vendosi që me datën 13 janar të fillohet me veprimin e parë sindikal (grevë një-orëshe në të dy ndërrimet), me datën 22 janar veprimi i dytë sindikal (grevë dy-orëshe në të dy ndërrimet) dhe me datën 30 janar me veprimin e tretë sindikal (grevë një-ditëshe), me hapësira kohore mes veprimeve, me qëllim që t'i ipet

mundësi institucioneve të reflektojnë pozitivisht në përmbushjen e kërkesave tona.

Nga diskutimet në Këshillin Drejtues, u konstatua se duhet implementuar në tërësi Kontrata Kolektive, e në theks të veçantë u vendosën këto kërkesa :

Shujta në shumë prej 2 euro në ditë për ditët e punës,
Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit në vlerë 70% e biletës së udhëtimit brenda territorit të komunës,
Pagesa e përvojës së punës 0.5% për vite të shërbimit,
Pagesa e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit



Kështu me datën 13 janar 2015, ora e parë e të dy ndërrimeve në të gjitha shkollat e Kosovës nuk u mbajt.

Në të gjitha komunat e Kosovës, përveç të gjitha shkollave që janë anëtare të SBASHK-ut, grevës një-orëshe iu bashkëngjiten edhe

numër i madh i shkollave që për momentin nuk janë anëtare të SBASHK-ut, ku edhe gjatë asaj dite kemi pasur edhe anëtarësime të reja.

Një numër i vogël i shkollave (34 shkolla) ishin grevëthyes, posaçërisht ato që nuk janë anëtare të SBASHK-ut, në mesin e këtyre shkollave grevëthyes më së shumti kishte në komunën e Podujevës (15 shkolla, prej tyre vetëm 3 janë anëtare të SBASHK-ut) ,në Prishtinë 7 shkolla, Fushë Kosovë 5 , Suharekë 1 shkollë dhe në Mitrovicë 1 shkollë. Krahësuar

me numrin e përgjithshëm të shkollave amë dhe paralele të ndara (1110 shkolla) del të jetë një numër shumë i vogël që kanë mbajtur mësim orën e parë.

Nga data 13 deri më datën 21, kryetari i SBASHK-ut z.Rrahman Jasharaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë pati takime me MASHT-in disa herë por këto takime nuk rezultuan të suksesshme, kështu që SBASHK-u me datën 21 janar 2015 në Konferencë për medie njoftoi anëtarësinë se do të vazhdoj me veprimin e dytë sindikal.



Me datën 22 janar 2015, dy orët e para në të dy ndërrimet nuk u mbajt mësim, në shenjë proteste për mos-zbatimin e plotë të Kontratës Kolektive.

Grevës dy-orëshe iu bashkëngjiten edhe sindikata e Universitetit të Prishtinës (SUSHK), e cila i përkrahi kërkesat e Këshillit

Drejtues të SBASHK-ut të datës 10 janar 2015 dhe njëkohësisht shtoi edhe një kërkesë që ka të bëjë me nënshkrimin e Kontratës Kolektive të nivelit universitar në mes të SUSHK-ut dhe Këshillit Drejtues të UP-së, e cila Kontratë ishte premtuar por nuk është nënshkruar.

Veprimet të dytë sindikal iu përgjigjen të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar, përveç 23 shkollave, të cilat kanë mbajtur mësim e që nuk janë anëtare të SBASHK-ut.

Pas veprimit të dytë sindikal, i cili ishte edhe më i fuqishëm se i pari, SBASHK-u mbajti përsëri

takime edhe me MASHT-in po ashtu ishte i ftuar edhe nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, po as nga këto takime nuk pati rezultate konkrete, kështu që përsëri me datën 28 janar 2015 u mbajt takimi me të gjithë kryetarët e sindikatave komunale të AF dhe AM në të cilin takim u dakorduan për agjendën e grevës një-ditëshe duke filluar nga ora 8 deri në 12, e cila agjendë u bë publike për anëtarësinë përmes konferencës për medie të mbajtur me datën 29 janar 2015.

Implemented by:



Ky veprim dëshmoi unitetin e fuqishëm të SBASHK-ut, ku nga 1110 shkolla amë dhe paralele të ndara të arsimit parauniversitar,

vetëm 18 shkolla kanë mbajtur mësim, gjë që dëshmoi përkrahjen e madhe të mësimdhënësve në kërkim të gjetjes së rrugës për realizimin e Kontratës Kolektive. Gjatë tri veprimeve sindikale, kryetari i SBASHK-ut z.Jasharaj e gjithashtu edhe anëtarët e kryesisë vizituan shkolla të ndryshme në komuna të ndryshme, ku u takuan për së afërmi me anëtarësinë dhe

bashkëbiseduan. Në të gjitha takimet, kërkesë e anëtarësisë ishte që të vazhdohet me veprime sindikale deri në përmbushje të kërkesave, për cka edhe kryetari i SBASHK-ut edhe anëtarët e tjerë të kryesisë që ishin nëpër vende të ndryshme, iu prematuan anëtarësisë se asnjë vendim nuk do të merret në kundërshtim me kërkesat e paraqitura, pa miratimin paraprak nga ju.

Në vazhdim po paraqesim rrjedhën e veprimeve sindikale në disa komuna:

Gjakovë – z. Sali Maliqi (Kryetar i SAF & SAM dhe kryetar i Këshillit Grevist në këtë komunë)

Ashtu sikurse që ishin deklaruar me shkrim anëtarësia e komunës së Gjakovës për veprime për mbështetje të organeve të SBASHK-ut për të ndërmarr veprime sindikale në rast të moszbatimit të Kontratës Kolektive ashtu edhe iu përgjigjen thirrjes



së Këshillit Drejtues të SBASHK-ut për veprimet sindikale të datës 13, 22 dhe 30 janar 2015, ku me kohë të gjitha shoqatat sindikale formuan Këshillat Greviste dhe të gjitha shkollat në përpikëri e zbatuan qëndrimin e organeve të SBASHK-ut për këto tri veprime sindikale.

Vlen të ceket se gjatë tri veprimeve sindikale në këtë komunë nuk ka ndodhur asnjë parregullsi.

Këshilli Komunal Grevist gjatë grevës vizitoi shumë shkolla dhe bashkëbisedoi me anëtarësinë, të cilët shprehën lëvdata për informimin dhe mbrojtjen e kërkesave të anëtarësisë si nga niveli qendror ashtu dhe ai komunal. Mësimdhënësit kërkuar që përveç këtyre pikave që kanë

implikime buxhetore dhe janë kërkesa të KD-së në përputhje me kërkesat e anëtarësisë ,edhe pikat tjera të Kontratës Kolektive duhet të realizohen në tërësi.

Gjilan – z.Blerim Mehmeti (Kryetar i SAF & Sam)



Greva e thirrur nga SBASHK-u ka vajtur shumë mirë. Të gjitha shkollat iu kanë përgjigjur gati 100%. Po them gati 100% sepse kemi pas disa arsimitarë që nuk iu kanë përgjigjur ftesës dhe numri i tyre ka qenë shumë i vogël, gati i papërfillshëm. Vlen të përmendet se edhe shkollat që nuk janë pjesë e jona iu kanë përgjigjur grevës. Unë bashkë me kryesinë kemi bërë një mori aktivitete parapërgatitore. Po ashtu edhe në tri veprimet sindikale kemi vizituar disa shkolla. Aktivitetin tonë e kanë përcjellur shumë mirë edhe mediet lokale si: "Rajonipress", "Radiostar", "xlpres.tv", etj.

Mitrovicë – znj.Vjollca Shala (UD Kryetare e SAF & SAM)

Me 12 janar 2015 e informuam Drejtoreshën Komunale të Arsimit në Mitrovicë znj.Ajmane

Barani që nesër me 13 janar 2015 të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Mitrovicës do të jenë në grevën njëorëshe në të dy ndërrimet sipas vendimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut të sjellë me 10 janar 2015. Drejtoresha Barani dhe zëdhënësi i komunës së Mitrovicës kërkuar nga ne që të dalim me një komunikatë që nesër me 13 janar 2015 nuk ka grevë ,por ne nuk u pajtuam me këtë.

Dhe me 13 janar 2015 të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Mitrovicë përveç shkollës së mesme të ulët "Ismajl Qemajli" ishin në grevën njëorëshe në të dy ndërrimet. Grevën e mbështetën edhe shkollat që nuk janë anëtare të SBASHK-ut si shkolla e mesme e lartë "Hasan Prishtina" ,shkolla e mesme e ulët "Fazli Grajqevci", "Elena Gjika", "Bislim Hajdari".

Me 21 janar isha e ftuar nga Drejtoresha Komunale e Arsimit në Mitrovicë znj.Ajmane Barani në mbledhjen e Drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme të Mitrovicës. Në këtë mbledhje kërkoja nga drejtorët e shkollave që mos t'ju bëhet presion mësimdhënësve për grevën dyorëshe që do të mbahet me 22 janar 2015, pasi mësimdhënësit kanë të drejtë në grevë dhe kërkesa e tyre për implementim të Kontratës Kolektive është legjitime.

Implemented by:

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Dhe me 22 janar 2015 të gjitha shkollat fillore dhe shkollat e mesme në Mitrovicë përveç shkollës së mesme të ulët "Ismajl Qemajli" ishin në grevën dyorëshe në të dy ndërrimet. Grevën e mbështetën edhe shkollat që nuk janë anëtare të SBASHK-ut. E njëjta ndodhi edhe me datën 30 janar, në grevën një-ditëshe.

Prizren – z.Reshit Kushaj (kryetar i SAF & SAM)

Dita e parë e grevës ne kohen prej një ore mësimore është respektuar nga te gjithë mësimmhënësit ne te gjitha ndërrimet mësimore si dhe është me rendësi se dhe nga te gjitha komunitetet e mësimmhënësve pasi qe ne Prizren mësimi zhvillohet edhe ne gjuhen boshnjake , turke si dhe ne atë rome, për hir te informimit sa me objektiv ju njoftoj se vetëm ne SHFMU:"Ibrahim Fehmiu" grevën ne ditën e par prej një ore nuk e kanë respektuar vetëm dy mësimmhënës, dhe po ashtu është me rendësi se ne komunën e Prizrenit greva është respektuar edhe prej atyre mësimmhënësve qe nuk janë ne radhët e SBASHK-ut (nuk janë anëtar te SBASHK-ut,) deh është me rendësi se pas organizimit te grevës dhe gjatë vizitave qe i kemi bë ne shkolla ne kryesia e SBASHK-ut, komunal ka interesime shumë për tu anëtarësuar ne SBASHK.



Po ashtu greva është organizuar dhe respektuar prej te gjithë mësimmhënësve edhe ne ditën e dyte ne kohe zgjatje prej dy ore mësimore dhe ditën e tretë të veprimit sindikal një-ditësh si dhe është me rendësi se ka kaluar pa asnjë ekses as me te voglin , pasi qe është

respektuar rekomandimi i SBASHK-ut edhe nga nxënësit dhe prindërit si dhe nga drejtuesit e institucioneve.

Ne anëtarësia e SBASHK-ut ,ne Prizren jemi te gatshëm qe te veprojmë gjithnjë sipas udhëzimeve ,detyrave dhe obligimet qe do te na jepen nga SBASHK-u ne shkallë vendi.

Ferizaj – z.Rexhep Sadiku (Kryetar i SAF&SAM dhe kryetar i Këshillit Grevist në këtë komunë) Në të tri veprimet sindikale të organizuara nga SBASHK-u, anëtarët dhe shkollat e kësaj komune kanë qenë të përfshira 100%.

Gjatë këtyre tri ditëve të veprimeve sindikale, këshillat greviste kanë funksionuar mirë. Çdo gjë ka shkuar sipas skenarit të paraparë.

Mësimmhënësit kanë qenë në lartësinë e punës prej pedagogu. Nuk ka pasur asnjë ekces. Të gjithë mësimmhënësit e komunës së Ferizajt kërkojnë që edhe më tej SBASHK-u të vazhdoj me mjetet sindikale që i ka në dispozicion, deri në arritjen e zbatimit të plotë të Kontratës Kolektive.

Pejë – z.Isuf Lajqi (Kryetar i SAF & SAM)

Sindikalistët arsimor të Komunës së Pejës iu përgjigjen shumë pozitivisht grevës së organizuar nga SBASHK-u .Si në grevën një orëshe, atë dy orëshe dhe një-ditëshe Sindikalistët e Pejës ishin shumë të vendosur në përkrahjen e detyrimit të Qeverisë Kosovare që Kontrata e nënshkruar më, 11.04.2014 në mes SBASHK e MASHT të zbatohet e tëra në përpikëri. Ju njoftojmë se Sindikata e Arsimit Parauniversitar në Pejë po mbanë takime të rregullta më Kryesinë e Kuvendit të SAF & SAM më qëllim të përcjelljes së situatës së arsimit në Pejë.

Vlen të theksohet se ishin formuar Këshillat Grevist në çdo Shoqatë e edhe në Kuvend të cilët Këshilla kanë përcjellur gjendjen në përgjithësi. Janë vizituar shumë Shkolla edhe nga organet Komunale të Pejës ku janë njoftuar për se afërmi me kërkesat e

Sindikatës të cilat e detyruan SBASHK-un për veprime Sindikale.

Në Pejë ecuria e veprimeve sindikale ishte: Nga 36- shkolla (sa ka në këtë Komunë) greva u respektua 100% në ato shkolla ku ishte e arsyeshme të mbahet (Nuk u mbajt në shkollën Xh. Deda- speciale , P. e Paqës-Çerdhe dhe 3- individ me numër të reduktuar nxënësish). U vizituan shumë Shoqata Sindikale nga Këshilli Grevist i SAF & SAM- Pejë ku u njoftuam për se afërmi me respektimin e grevës. Gjatë vizitës u morën shumë mendime dhe lëvdato për punën e Sindikatës në nivelin



Lokal e Qendror dhe iu dha përkrahje të gjitha vendimeve të SBASHK-ut. Lavdëruan çdo Bisedë, Intervistë, Konferencë e Emision ku kryetari z. Rr. Jasharaj doli dhe e laboroi punën, interesimin dhe kërkesat e Sindikatës (gjë e cila rezultoi me anëtarë të ri).

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Në korrik mbahet Kongresi i 7-të i Edukimit Internacional (EI)

SBASHK-u përfaqëson Kosovën në Otavë (Kanada)

delegacione nga 401 sindikata anëtare të EI-së nga 171 vende të botës. Pjesëmarrës në këtë takim të madh e me rëndësi për arsimin në gjithë globin janë edhe delegatët nga SBASHK-u.

EI përfaqëson organizatat e mësimdhënësve dhe punonjësve tjerë të arsimit në të gjithë globin. Është organizata më e madhe në botë e sindikatave që përfaqëson 30 milionë punëtorë të arsimit.

EI bashkon të gjithë mësimdhënësit dhe punonjësit e arsimit dhe është zë për të gjithë punonjësit e arsimit në të gjithë globin.

SBASHK-u është anëtare e EI-së që nga viti 1996.

Në këtë Kongres, ku do të marrin pjesë të gjitha sindikatat e arsimit, të cilat janë anëtare të EI- do të debatohen shumë materiale e do të nxirren Konkluzione në shërbim të bashkëpunimit edhe më të fuqishëm mes anëtarëve të EI-së e po ashtu do të nxirren dokumente që obligojnë shtetet në botë që të angazhohen më shumë në përmirësimin e kushteve të punës në institucionet arsimore, në përmirësimin e mirëqenies së të punësuarve në arsim dhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

Delegacioni i SBASHK-ut gjatë këtij Kongresi do të ketë mundësi të takohet me të gjitha delegacionet nga shtetet e botës dhe do të prezantojë në seancat e Kongresit gjendjen e arsimit në Kosovë duke kërkuar mbështetje nga vendet anëtare të EI-së për dialogun social dhe forcimin e rolit të SBASHK-ut në përballje me sfidat e kohës.

SBASHK-u u takua me Kryeministrin Mustafa

As takimi me Kryeministrin nuk solli marrëveshje

dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri kanë marrë pjesë në një takim të organizuar nga Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, z. Isa Mustafa, që shoqërohej nga zëvendës kryeministri, z. Hashim Thaçi, Ministri i Financave, z. Avdullah Hoti, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi dhe Këshilltari i Ministrit të Arsimit, z. Azem Guri.

Edhe Kryeministri edhe zv/kryeministri u deklaruan se janë në përpjekje për gjetjen e mundësive që do të mundësonin realizimin e kërkesave të shumta, por ata kanë apeluar që të kemi mirëkuptim dhe t'u jepet kohë. Ata në këtë takim kanë shtuar se 3 kërkesat e SBASHK-ut do të realizohen dhe na duhet mirëkuptim dhe kohë për gjetjen e mundësisë së realizimit të kërkesës së katërt e që është shujta. Përfaqësuesit e SBASHK-ut edhe një herë kanë bërë të ditur se veprimet sindikale që ka vendosur Këshilli Drejtues i SBASHK-ut janë tërësisht në mbrojtje të implementimit të Kontratës Kolektive të nënshkruar me SBASHK-ut dhe MASHT-it. Ata apeluan edhe një herë te Kabineti Qeveritar që të reflektojnë në realizimin e kërkesave sepse në të kundërtën veprimet sindikale do të vazhdojnë. SBASHK-u do t'i shtojë edhe më përpjekjet në takime me institucionet e shtetit e veçmas me MASHT-in në kërkim të gjetjes së zgjidhjes, gjithmonë duke respektuar mendimin e anëtarësisë.

Takim në MASHT

SBASHK-u u takua me Ministrin Bajrami



e realizimit të plotë të Kontratës Kolektive, kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj dhe menaxheri financiar i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri u takuan me Ministrin e MASHT-it, z. Arsim Bajrami më 6 janar, 9 janar dhe 29 janar 2015, ku u bisedua rreth kërkesave të sindikalistëve të arsimit adresuar Qeverisë së Kosovës.

SBASHK-u përsëriti kërkesën e anëtarëve të saj për fillimin e implementimit të Kontratës Kolektive për mësimdhënësit që nga 1 janari i këtij viti.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, premtoi angazhimin e tij maksimal rreth realizimit të të gjitha kërkesave të sindikalistëve. "Unë i përkrah kërkesat tuaja, sepse janë kërkesa legjitime dhe të arsyeshme. Ne po punojmë çdo ditë që këto kërkesa të realizohen në tërësi".

Por, ministri kërkoi mirëkuptim nga sindikalistët dhe mësimdhënësit në përgjithësi për çështjet të cilat marrin kohë për t'u realizuar.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Marrëveshje të reja në shërbim të anëtarësisë SBASHK-u vazhdon me angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Ka arritur në 90 numri i marrëveshjeve të SBASHK-ut me bizneset e vogla e me institucione

arsimore e shëndetësore për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e SBASHK-ut, numri i të cilëve sa vjen e shtohet.

Kohëve të fundit janë arritur dy marrëveshje me rëndësi. Njëra me "Medicine Hospital" për zbritje çmimesh prej 15 % për të gjitha shërbimet e ofruara këtu. Ky institucion shëndetësor, përveç kësaj zbritjeje, do të punojë edhe kartela për anëtarët e SBASHK-ut dhe poseduesit e tyre do të kenë edhe një zbritje prej 5% dhe një vizitë shëndetësore në vit pa pagesë. Pra, anëtarët e SBASHK-ut do të gëzojnë zbritje prej 20 % për shërbimet mjekësore në këtë.. institucion shëndetësor.

Qendrës Estetike Italiane (QEI) në Kosovë ka ofruar një dhuratë për 8 marsin.

Anëtarët e SBASHK-ut në këtë Qendër do të kenë shërbime të shumta me një zbritje të madhe prej 50 %. SBASHK-u edhe me këtë rast falënderon dhe shpreh respekt për gjithë pronarët e bizneseve të vogla dhe institucioneve arsimore e shëndetësore që kanë lidhur marrëveshje për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e SBASHK-ut kudo në Kosovë.

Inkurajojmë solidaritetin! Fillon një konkurs i ri i garës ndërkombëtare shkollore.

ACES - Akademia e Shkollave të Evropës Qendrore hap një cikël të ri të garës për projektet shkollore dhe shkëmbimin e nxënësve "Inkurajojmë solidaritetin: kujdesemi për të tjerët dhe ndajmë atë që kemi!" - kjo është tema e konkursit të këtij viti, të projekteve shkollore ndërkufitare. Për të tetën herë me radhë, ACES - Akademia e Shkollave të Evropës Qendrore fton arsimtarët dhe nxënësit për të hartuar dhe zbatuar projekte të reja në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Propozimet e projekteve mund të dorëzohen në periudhën nga 15 janari deri me 15 prill 2015. Shkollat që paraqesin projektet më të mira do të fitojnë çmime me vlerë monetare.

ACES paraqet një projekt të iniciuar nga Fondacioni ERSTE në fushën e arsimit, dhe për koordinimin e iniciativave janë përgjegjëse organizata autriake Qendra Ndërkulturore dhe shoqata Sllovake VČELI DOM. Ky rrjet shkollor është aktiv që nga viti 2006 në të gjithë Evropën Qendrore dhe Juglindore, dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë është avancimi i shkëmbimit dhe të dialogut kulturor midis të rinjve. Në rrjet janë përfshirë 15 shtete të rajonit EQL, me mbështetjen e ministrive të arsimit. Deri më tash, më shumë se 25.000 nxënës dhe 3600 arsimtarë kanë marrë pjesë në programin ACES.

Për më shumë informata rreth këtij konkursi mund të vizitoni ueb-faqen tonë : www.sbashk-rks.org

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsime dhe Kulturë

KEC



EI/ETUCE mbështetin SBASHK-un



Që veprimet e SBASHK-ut janë të drejta, dëshmojnë edhe mbështetjet që kanë arritur nga EI (Edukimi Internacional), gjegjësisht nga ETUCE (Komiteti Evropian i Sindikatave të Arsimit), ku përveq letrës mbështetëse që i kanë dërguar SBASHK-ut, me një letër në

favor të realizimit të kërkesave të SBASHK-ut i janë drejtuar edhe Kryeministrit të Kosovës z.Isa Mustafa dhe Ministrit të MASHT-it z.Arsim Bajrami.

Ndër tjerash në këtë letër dërguar institucioneve të Kosovës thuhet se: "Qeveria juaj duhet të mbante përgjegjësinë e saj si partner social dhe të respektojë angazhimet e saj në kontratën kolektive për të garantuar arsim cilësor më të mirë për të gjithë në Kosovë..."

Përveq mbështetjes nga EI/ETUCE, po i përmendim edhe disa nga sindikatat e arsimit, të cilat na dërguan letër përkrahëse në mbrojtje të Kontratës Kolektive e që janë nga Sllovenia, Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria, Polonia, Mali i Zi etj.

SBASHK-u i falënderoi këto sindikata dhe iu garantoi se gjithëmonë do të punoj konform rregullave të EI-së, statutit të SBASHK-ut, ligjeve të Republikës së Kosovës dhe konventave ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve.